



RAPORTI VJETOR I SIGURISË-2016



DEPARTAMENTI I SIGURISË

Rr. Rustem Statovci, 29 • +381 38 22 00 40 ext 119 • Afrim.Mehmetaj@rks-gov.net

9/30/2017

A. PARATHËNIE	3
B. PJESA HYRËSE	4
1. <i>Hyrje në raport.....</i>	<i>4</i>
3. <i>Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore(NH).....</i>	<i>6</i>
5. <i>Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë</i>	<i>8</i>
6. <i>Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit.....</i>	<i>9</i>
C. ORGANIZIMI	11
1. <i>Prezantimi i organizimit</i>	<i>11</i>
D. ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE	13
1. <i>Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë</i>	<i>13</i>
2. <i>Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave.....</i>	<i>14</i>
E. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE	18
F. ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË.....	19
G. BURIMET E INFORMACIONIT	29
ANEKSI A STRUKTURA E INFORMACIONEVE HEKURUDHORE	30
ANEKSI B - STRUKTURA ORGANIZATIVE	34
ANEKSI C.....	38

A. PARATHËNIE

1. Qëllimi, fushëveprimi dhe të dhënat tjera të raportit

Obligimi për të përgatitur Raportin Vjetor të Sigurisë (RVS) rrjedh nga dispozita e nenit 20 të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës si dhe nga neni 18 i Direktivës 2004/49/EC për Sigurinë hekurudhore të Bashkimit Evropian (BE). Nga departamenti i Sigurisë kërkohet që të përgatitet dhe të publikohet RVS. Raporti mbulon aktivitetet kryesore të departamentit të sigurisë nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016. Qëllimi i këtij RVS është që të ofrojë informacion në lidhje me nivelin e sigurisë hekurudhore.

RVS për vitin 2016 mbulon aktivitetet e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH), respektivisht aktivitetet e departamentit të Sigurisë gjatë vitit 2016, ky është raporti i pestë (5) me radhë të cilin e paraqesim te drejtori i përgjithshëm dhe te bordi i ARH-së. Objektivat dhe përmbajtja e raportit janë të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës.

Ky raport i përshkruan aktivitetet e vitit paraparak të departamentit të sigurisë, menaxherit të infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjes Hekurudhore (NH). Informacionet kryesore që i përmban raporti janë:

- a. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS),
- b. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativ në lidhje me sigurinë hekurudhore,
- c. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë,
- d. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e MI dhe të NH,
- e. përjashtimet të cilat nëse vendoset të bëhen nga departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Raporti është i bazuar në modelin e zhvilluar nga Bashkimi Evropian Agjensioni për hekurudha (ish European Railway Agency- ERA), dhe përmban të gjitha çështjet të cilat janë paraqitur në nenin 18 të Direktivës 2004/49/EC.



Fig.1.

B.PJESA HYRËSE

1. Hyrje në raport

RVS përgatitet nga departamenti i sigurisë në kuadër të ARH-së, në përputhje me ligjin 04/L-063 Neni 20 për hekurudhat në republikën e Kosovës si dhe nenit 18 të Direktivës 2004/49/EC.

Struktura e këtij raporti është në përputhje me rekomandimet (modelit dhe udhëzimit) e Bashkimit Evropian Agjensioni për Hekurudha (ERA).

Raporti i sigurisë përgatitet duke u bazuar në radhë të parë nga informacioni i siguruar nga aktivitetet e departamentit të sigurisë të kryera gjatë vitit si dhe nga informatat e raporteve vjetore të:

1.1 Menaxherit të Infratsrukturës (MI)-Infrakos, i cili ka një autorizim të vlefshëm të sigurisë në qe nga janari i vitit 2013.

1.2 Ndërmarrjes Hekurudhore (NH)-Trainkos, i cili ka një certifikatë të vlefshme të sigurisë qe nga janari i vitit 2013.

1.3 Ndërmarrjes Hekurudhore (NH)-Railtrans, i cili ka një certifikatë të vlefshme të sigurisë qe nga tetori i vitit 2016.

2. Shtrirja e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës

Hartat e bashkangjitura (Aneksi A. 1.) tregojnë të gjithë rrjetin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

Rrjeti hekurudhor në Republikën e Kosovës është i ndarë në këto linja:

- **Linja Veri – Jug** që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. (Linjë funksionale).

▪ Linja Verilindje deri në Perëndim që përbëhet nga tri degë:

- **Linja Lindore** nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me 45 km gjatësi. Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (Linjë funksionale)Bardhosh-Podujevë 30 km (Linjë jo - funksionale)

- **Linja Perëndimore** , Fushë Kosovë-Pejë me 81 km gjatësi (Linjë funksionale),

- **Linja Jug-Perëndim**, Klinë-Prizren me 58 km gjatësi.

Klinë – Xërxe 35 (Linjë funksionale)

Xërxe – Prizren 23 (Linjë jo-funksionale)

Me vendimin e Qeverisë së Kosovës më 01.09.2011 është bërë ndarja e Hekurudhave të Kosovës ShA në dy kompani të reja:

- ❖ Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës **INFRAKOS Sh.A**, dhe
- ❖ Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës **TRAINKOS Sh.A**.

Hekurudhat në Kosovë kanë një histori të gjatë, gjegjësisht në vitin 1874 u ndërtua linja e parë hekurudhore në Kosovë në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Ishte ky fillimi i shtrirjes së rrjetit hekurudhor nëpër Kosovë, aq sa i rëndësishëm për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, po aq i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit. Në vitin 1931 vazhdoi ndërtimi i kësaj linjës në relacionin Mitrovicë – Leshak, më 1934 ajo Fushë Kosovë – Prishtinë, më 1936 Fushë Kosovë – Pejë, më 1949 Prishtinë – Podujevë – Livadhi dhe më 1963 Klinë – Prizren.

Kështu që sot Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,951 km linjë e hapur hekurudhore, me një gjatësi prej 105,784 km në stacione dhe 103,4 km linja industriale. Hekurudhat e Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në veri dhe lindje janë të lidhura me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit, në jug me Maqedoninë.

3. Lista e Menaxherëve të Infrastrukturës (MI) dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore(NH)

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i Menaxherve të Infrastrukturës që ka një Autorizim të vlefshëm të sigurisë Pjesa A dhe B, si dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore të cilat gjithashtu kanë Certifikatë të vlefshme të Sigurisë Pjesa A dhe B.

4. Analizë e Përgjithshme në zhvillimet e sigurisë hekurudhore, autorizimi, certifikimi, autorizimi i futjes në shërbim etj)

Nr.	Emërtimi i kompanisë	Autorizim i Sigurisë pjesa A dhe B		Certifikatë e Sigurisë pjesa A dhe B	
1.	Menaxheri i Infrastrukturës (Infrakos)	24.01.2013	24.01.2013		
2.	Ndërmarrja Hekurudhore (Trainkos)			24.01.2013	24.01.2013
3.	Ndërmarrja Hekurudhore (Railtrans)			04.10.2016	04.10.2016


Tab. 1.

Në vitin 2016 numri i aksidenteve dhe incidenteve është 14, ka një rënie për 21.40 % në krahasim me vitin 2015 që ishte 17.

Numri i personave të cilët ishin të lënduar në vitin 2016 është 17, kemi një rritje prej 54.50 % në krahasim me vitin 2015 që ishte 11.

Në vitin 2016 numri i përgjithshëm i viktimave është (1), pra kemi një zvogëlim prej 50.00 % ne krahasim me vitin 2015 qe ishte 2.

Ne vitin 2015 Demet materiale ne infrastrukturën hekurudhore kane qene 4759.25 € ndërsa ne vitin 2016 janë 6849.25 €.




Tab.2.


Me poshtë janë te paraqitura diagramet për ngjarjet e jashtëzakonshme, te cilat kane te bëjnë me persona te lënduar, demet materiale ne hekurudha si dhe personat e vdekur për periudhën pesë vjeçare.

	Nr. i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Nr. i personave të vdekur	Nr. i personave të lënduar	Dëmet materiale në hekurudhat e Kosovës
2012	25	3	6	44322.24
2013	17	2	17	3327.90
2014	13	3	14	825.00
2015	17	2	11	4759.25
2016	14	1	17	6849.50


Tab.3.



Tab.4.



Tab.5.



Tab.6.

5. Autorizimi i Sigurisë dhe Certifikata e Sigurisë

Ashtu siq parashihet me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës, rregulloren e ARH-së Nr. 03/2012 për autorizim të sigurisë dhe si rregulloren e ARH-së Nr.02/2012, po ashtu edhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloret e Komisionit Nr.1169/2010/EU, Nr.1158/2010/EU, parashohin kriteret për dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për MI dhe NH. Secili MI së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr Autorizimin e Sigurisë, duhet të konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe konfirmon pranimin e dispozitave të MI për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje dhe operim të sigurt në infrastrukturën hekurudhore, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit, kur është e përshtatshme.

Secila NH që mban licencë, duhet të merr Certifikatën e Sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i Certifikatës së Sigurisë është të ofroj dëshmi se ndërmarrja hekurudhore ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë (SMS) dhe mund të plotësoj kërkesat e paraqitura në TSI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së, si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve për transport të sigurt në rrjetin hekurudhor.

6. Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale dhe mjeteve të transportit

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-063, për hekurudhat në Republikën e Kosovës, neni 18 paragrafi 3.1, 3.3 neni 109, 110 dhe 111 secili mjet lëvizës para se të futet në shërbim duhet të autorizohet nga Departamenti i Sigurisë.

Gjatë viti 2016 departamenti i sigurisë ka autorizuar një numer të konsiderueshëm të mjeteve lëvizëse, gjithësej janë autorizuar për tu futur në shërbim dhjetë (10) mjete lëvizëse në pronësi të Infrakos, Trainkos dhe Railtrans.

1. Infrakos me datë 15.12.2015, ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 5 (pesë) *Drezina të lehta, të tipit LMD-9*, "Light Track Motor Car", nga prodhuesi MINDIV-Svrljig, të cilat përdorën për transport të punëtorëve dhe mjeteve të punës në vend punime, si dhe për inspektime të cilat kryhen nga departamenti i mirëmbajtjes-Infrakos.
2. Infrakos me datë 15.12.2015, ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 3 (tre) *Valter "ZTK-10"*, të cilët përdorën për ngarkim, zbarkim dhe transport të shinave nga departamenti i mirëmbajtjes-Infrakos.
3. Trainkos me datë: 11.03.2016, ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) *Lokomotive dizel-elektrike* për transport të kombinuar udhëtar-mallra.
4. Railtrans me datë: 22.06.2016, ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) *Lokomotive dizel-hidraulike* me numër serik 55-230-7, për transport të mallrave.

Në fillim të vitit 2016 kemi filluar me shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Infrakos për 5 (pesë) *Drezina të lehta, të tipit LMD-9*, si dhe pas shqyrtimit të hollësishëm kemi arritur në vlerësimin se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur, dhe në këtë mënyrë me datë: 26.02.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për 5 (pesë) *Drezina të lehta, të tipit LMD-9*.

Me datë: 26.02.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për 5 (pesë) Drezina të lehta, të tipit LMD-9, të Infrakos-it

Gjithashtu paralelisht kemi vazhduar edhe me vlerësimin e të gjithë dokumentacionit të ofruar nga Infrakos për 3 (tre) Valter “ZTK-10”, si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar kemi vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur, dhe në këtë mënyrë me datë: 26.02.2016, kemi dhënë Autorizimi për futjen në shërbim për 3 (tre) Valter “ZTK-10”.

Me datë: 26.02.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për 3 (tre) Valter “ZTK-10”, të Infrakos-it

Gjithashtu edhe nga Trainkos kemi pranuar një kërkesë për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-elektrike, kjo lokomotivë ka qenë e paraparë që të përdoret për transport të kombinuar udhëtar-mallra. Ne kemi vlerësuar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit me trena Trainkos. Pasi që ne kemi vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim të Lokomotivës për transport të kombinuar udhëtar-mallra janë përmbushur, me datë: 06.05.2016 departamenti i sigurisë ka dhënë autorizimin për futjen në shërbim për këtë lokomotivë.

Me datë: 06.05.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-elektrike, të Trainkos-it

Gjithashtu departamenti i sigurisë me datë: 22.06.2016, ka pranuar një aplikacion për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) Lokomotive dizel-hidraulike me numër serik 55-230-7, për transport të mallrave në pronësi të operatorit privat Railtrans. Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të ofruar nga kompania Railtrans, me datë: 25.07.2016, kemi kërkuar që të na ofrohet dokumentacion shtesë për disa teste, për të cilat kemi vlerësuar se janë të domosdoshme për përfundimin e vlerësimit të aplikacionit në tërësi. Nga kompania Railtrans me datë: 28.09.2016, kemi pranuar dokumentacionin e kërkuar nga ana e jonë, si dhe pasi që ne kemi vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet që të japim autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel –hidraulike në pronësi të operatorit privat Railtrans dhe me datë: 06.10.2016, kemi dhënë autorizimin për lokomotivën e cekur më lartë.

Me datë: 06.10.2016, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-hidraulike, të Railtrans-it

7. Organizimi i misionit të ekspertëve për procedurat e dhënies së autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës

Gjatë vitit të kaluar, respektivisht me datë: 30-31.03.2016 nëpërmes instrumentit të TAIEX kemi mbajtur një trajnim me dy ekspertë nga Franca -Pierre Desfray, nga agjensioni i sigurisë hekurudhore (EPSF) si dhe Christian Weber hekurudhat shtetërore të Francës (SNCF). Tema e trajnimit ishte autorizimi për futje në shërbim të Infrastrukturës dhe Mjeteve Lëvizëse, duke u bazuar në praktikën dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë si dhe atë Evropian. Kjo kërkesë e jona për një mision të ekspertëve është mbështetur dhe financuar nga Komisioni Evropian nëpërmes instrumentit të TAIEX. Qështjet kryesore të trajtuara në këtë trajnim kanë qenë: Parimet e sigurisë, Interoperabilitetit, shembuj praktik të autorizimeve për futjen në shërbim të infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse, ndryshimet në pakon e katërt hekurudhore, sistemet dhe nënsistemet hekurudhore, dokumentet e nevojshme për aplikim për marrjen e autorizimit të futjes në shërbim etj.

Me datë: 30-31.03.2016, në ARH kemi mbajtur një trajnim dy ditor me temën: autorizimi për futje në shërbim të Mjeteve Lëvizëse dhe Infrastrukturës

C. ORGANIZIMI

1. Prezantimi i organizimit

Bazuar në ligjin 04/L-063, nenit 3 paragrafi 1.42. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) të Kosovës është institucion i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitet dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe departamentin për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji. ARH është themeluar në vitin 2010, në vitin 2016 kishte 16 të punësuar, prej tyre 3 janë në departamentin e sigurisë.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është krijuar dhe funksionon nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria mbahet dhe përmirësohet në sistemin hekurudhor të Kosovës.

Departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore është i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen në raport me ndonjë NH, MI, aplikues apo entitet i prokurimit.

Bazuar në ligjin 04/L-063 për hekurudhat në Republikën e Kosovës departamenti përgjegjës për sigurinë hekurudhore i janë besuar detyrat në vazhdim:

- a. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe kontrollimin që ato operojnë dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat esenciale;*
- b. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;*
- c. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;*
- d. lëshimi, përtëritja, amendamenti dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se MI dhe NH janë duke operuar sipas ligjit në fuqi;*
- e. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;*
- f. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;*
- g. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;*
- h. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës (RINF).*

ARH në rolin e autoritetit të sigurisë është gjithashtu pjesëmarrës i rregullt në takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Bashkimi Evropian Agjensioni për Hekurudha (European Union Agency for

Railways), si dhe në shumë aktivitete tjera të organizuara si nga SEETO po ashtu edhe nga vendet e tjera.



2. Struktura Organizative e ARH-së është paraqitur në Aneksin B.

D. ZHVILLIMET NË SIGURINË HEKURUDHORE

1. Iniciativat për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e performancës së sigurisë

Departamenti i Sigurisë duhet të siguroj që siguria hekurudhore përgjithësisht të mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe e nevojshme të përmirësohet, e gjithë kjo duke marrë parasysh legjislacionin e Kosovës për këtë sektor si dhe atë të BE-së.

Në mënyrë që të kemi një mbikëqyrje me efikase departamenti i sigurisë ka përdorur metodën për qasje ndaj rrezikut. Në planifikimin e aktiviteteve mbikëqyrëse jemi bazuar nga përvoja e raportimit të aksidenteve, incidenteve, inspektimeve si dhe përvojat nga proceset tjera janë përdorur në mënyrë aktive ashtu që prioritetet tona të fokusohen në aktivitetet që kanë një rrezikshmëri më të larta.

Niveli i sigurisë në sektorin hekurudhor në masë të madhe varet nga koordinimi ndërmjet ARH-së, MI dhe NH, për këtë arsye, niveli i sigurisë në hekurudha është përshkruar në formën e objektivave për përmirësimin e sigurisë që janë zbatuar nga të gjitha palët ARH, MI dhe NH.

Bazuar në informatat e më sipërme, ne kryesisht fokusohemi në:

- *Rrezikun individual i cili ndërlidhet me udhëtarët, stafin (përfshirë edhe stafin e kontraktuesve),*
- *Rrezikun individual të shfrytëzuesve të vendkalimeve (kryqëzimeve hekurudhë-rrugë) dhe të tjerëve,*
- *Rrezikun individual duke mos parqgjykuar rregullat e detyrueshme ekzistuese nacionale dhe rajonale,*

- *Rrezikun individual lidhur me personat e pa autorizuar në objektet hekurudhore,*
- *Riskun social,*
- *Përfshirja aktive nga menaxhmenti i lartë në siguri (duke përfshirë vlerësimet e menaxhmentit),*
- *udhëzime të brendshme për vendkalimet dhe pajisjet e sigurisë,*
- *Përdorimi aktiv i analizës së rrezikut (metoda e zakonshme e vlerësimit të rrezikut CSM RA.)*

Menaxheri i Infrastrukturës dhe Ndërmarrja Hekurudhore janë përgjegjës për sigurinë në rrjetin hekurudhor të Kosovës, ato duhet të implementojnë Sistemin e tyre për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) në mënyrë që të kontrollojnë rreziqet të cilat mund të shkaktojnë aksidentet dhe incidentet.

Organi përgjegjës për siguri duhet ti merr parasysh të gjitha rekomandimet nga organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore KHAIA dhe duhet të sigurojë që NH dhe MI i zbatojnë rekomandimet.

2. Analizimi i detajuar i trendit të të dhënave

Në mënyrë që të lehtësohet vlerësimi i arritjes së qëllimeve të përbashkëta të sigurisë (QPS) të zhvilluara në BE dhe të ofrohet monitorim i zhvillimit të përgjithshëm të sigurisë hekurudhore, Organi përgjegjës për sigurinë duhet të mbledhë informacion për treguesit e përbashkët të sigurisë (TPS) nëpërmes të raporteve vjetore të MI dhe NH siç është përcaktuar me ligjin për hekurudhat e Kosovës 04/L-063 dhe direktivës së sigurisë 2004/49/EC, ku si referencë i kemi paraqitur të dhënat për vitet 2012-2016.

Numri i aksidenteve:

2012	2013	2014	2015	2016
25	17	13	17	14

Tab.7.

Në vitin 2016 numri i aksidenteve dhe incidenteve është 14, ka një rënie për 21.40 % në krahasim me vitin 2015 që ishte 17.

Numri i të vdekurve:

2012	2013	2014	2015	2016
3	2	3	2	1

Tab.8.

Në vitin 2016 numri i përgjithshëm i viktimave është (1), pra kemi një zvogëlim prej 50.00 % në krahasim me vitin 2015 që ishte 2.

Numri i të lënduarve:

2012	2013	2014	2015	2016
6	17	14	11	17

Tab.9.

Numri i personave të cilët ishin të lënduar në vitin 2016 është 17, kemi një rritje prej 54.50 % në krahasim me vitin 2015 që ishte 11.

- 14 Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme
- 1 (një) qytetarë ka vdekur si pasojë e aksidenteve.
- 0 të vdekur si pasojë e vetëvrasjes
- 17 qytetarë kanë pësuar lëndime.
- 0 nuk ka pasur tentim për vetëvrasje


Viti	Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Të vdekur si pasojë aksidenti	Të Vetëvrasë	Të lënduar	Tentim vetëvrasje
2016	14	1	0	17	0

Tab.10.

Në vitin 2016, gjithësejt trena të udhëtarëve kanë qenë 5148 dhe kilometra të kaluara 282249 km, kurse në vitin paraprak 2015 ka pasur 282079 km(0.06% rritje të tren/km të udhëtarëve në krahasim me vitin paraprak), si dhe 1435 trena të mallrave dhe kilometra të kaluara 35934.5 km, ndërsa në vitin 2015 kanë qenë 2015 trena të mallrave dhe 111544 km, (pra një rënie prej 67.78 %, në krahasim me vitin paraprak) kjo ka ndodhur si pasojë e revokimit të trenave nga ana e operatorit Trainkos.

Viti	Kilometrat e kaluara të trenit të udhëtarëve	Kilometrat e kaluara të trenit të mallrave
2012	328305	132562
2013	281931	109183
2014	281986	120014
2015	282079	111544
2016	282249	35934.5

Tab.11.



Tab.12.

Krahasimi i parametrevë të sigurisë për 5 vitet e fundit

	Nr i ngjarjeve të jashtëzakonshme	Nr i personave të vdekur	Nr i personave të lënduar	Dëme materiale në hekurudhat e Kosovës
2012	25	3	6	44762.36
2013	17	2	17	10330
2014	13	3	14	825
2015	17	2	11	4759.25
2016	14	1	17	6849.50

Tab.13.

Rezultatet e rekomandimeve të sigurisë

Departamenti i sigurisë edhe gjatë vitit 2016 nuk ka pranuar asnjë rekomandim i cili ka të bëjë me sigurinë nga organi për hetimin e aksidentëve hekurudhore (KHAIA).

Rekomandimet e sigurisë hekurudhore duhet të përgatitën dhe shpërndahen nga Organi për Hetimin e Aksidentëve (KHAIA).

3. Zhvillimet në sigurinë hekurudhore janë paraqitur në aneksin C



Fig.2.




Fig.3.

E. NDRYSHIME TË RËNDËSISHME NË RREGULLORE, LEGJISLACION DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Në mënyrë që të harmonizohet kuadri ligjor në Kosovë me ato të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, parlamenti i Kosovës ka miratuar ligjin nr. 04/l-063 i datës 14.11.2011 hekurudhat e Kosovës (ka hyrë në fuqi me 01.01.2012), në të cilin ligj janë transponuar plotësisht nga *acquis* e BE-së direktiva e 2004/49; direktiva 2001/14, direktiva 91/440 dhe 95/18, direktiva 2007/59 dhe direktiva 2008/57 dhe pjesërisht direktiva 2012/34.

Për kryerjen e detyrave sipas ligjit për hekurudhat e Kosovës, struktura e ARH-së, përfshinë: menaxhmentin, departamentet dhe personelin mbështetës. çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç janë të rregulluara më këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nevojshme që nxjerrin vetë departamentet dhe menaxhmenti i ARH-së.

Departamente në kuadër të ARH-së janë:

- *Departamenti i sigurisë,*
- *Departamenti i tregut hekurudhor,*
- *Departamenti i interoperabilitetit,*
- *Departamenti i licencimit.*

Të gjitha të dhënat lidhur me ndryshimet në legjislacion, rregullore dhe dispozita administrative mund ti gjeni në ueb faqen e ARH: www.arh-ks.org

Departamenti i Sigurisë gjatë kësaj periudhe raportuese pra gjatë vitit 2016 ka përgatitur dy draft rregullore të cilat pritet të miratohen nga Bordi i ARH-së.

Këto draft rregullore janë përgatitur me qëllim të përmirësimit të procedurave për: marrjen e autorizimit të sigurisë për menaxher të infrastrukturës si dhe draft rregullorja për metodat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin dhe llogaritjen e rrezikut.

F. ZHVILLIMI I CERTIFIKATËS DHE AUTORIZIMIT TË SIGURISË

1. Legjislacioni nacional - data e aplikimit - disponueshmëria

Lëshimi i certifikatës dhe autorizimit të sigurisë bëhet në pajtim me nenin 94, nenin 104 të ligjit 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Direktivës 2004/49/EC.

Pas përgatitjes së të gjitha akteve nënligjore të domosdoshme për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë siç janë:

- Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2012 për lëshimin e certifikatës dhe autorizimit të sigurisë,
- Rregullores së ARH Nr. 02/2012, për dhënien e certifikatës së sigurisë,
- Rregullores së ARH Nr. 03/2012, për dhënien e autorizimit të sigurisë,
- Rregullores së ARH Nr. 06/2012, për regjistrimin e infrastrukturës.

Departamenti i sigurisë me datë:

26.11.2012, nga NH (Trainkos) ka pranuar aplikacionin për marrjen e certifikatës së sigurisë,
12.12.2012, nga MI (Infrakos) ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit të sigurisë, si dhe
02.02.2016, nga Railtrans ka pranuar aplikacionin për marrjen e certifikatës së sigurisë.

*Railtrans L.L.C me datë: 02.02.2016 ka aplikuar për
Certifikatë të Sigurisë pjesa A dhe B*

Në përputhje me ligjin 04/L-063 neni 104, për hekurudhat e Kosovës si dhe dispozitat e Direktivës 2004/49/EC dhe Rregulloren e Komisionit 1169/2010, Rregulloren 1158/2010, të cilat parashohin dhënien e autorizimeve dhe certifikatave të sigurisë Pjesa A dhe Pjesa B për MI dhe NH.

Duke e vlerësuar këtë aplikacion si shumë të rëndësishëm dhe si çështje të ndjeshme, pasi që ishte hera e parë që ne kemi pasur një aplikim nga një operator privat, kemi vlerësuar se do të ishte e nevojshme që të bëhet një kërkesë në TAIEK për dërgimin e një eksperti i cili do të na ndihmonte në vlerësimin e këtij aplikacioni.

Me datë: 10.02.2016, departamenti i sigurisë ka bërë një kërkesë zyrtare në TAIEK, që të kemi një ekspert nga Bashkimi Evropian i cili do të ndihmonte gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit, me

qëllim eliminimin e gabimeve eventuale, si dhe kemi kërkuar që në fund të procesit të kemi një rekomandim nga eksperti për aplikacionin e operatorit privat.



*TAIEX Expert Mission on Evaluation of Safety
Certificate Application for Railtrans*

Më datë: 6 dhe 7 Qershor 2016 ne kemi pasur ekspertin nga ORR (Russell Keir) Mbretëria e Bashkuar, me të cilin për dy ditë me radhë kemi analizuar aplikacionin e operatorit privat Railtrans. Në fund të ditës së dytë dhe pas analizimit të hollësishëm të aplikacionit për certifikatë të sigurisë kemi arritur deri te vlerësimi operatori privat railtrans i ka plotësuar kushtet për marrjen e certifikatës së sigurisë pjesa A dhe B por të kushtëzuar.

Kushti ka qenë që kompania Railtrans duhet që në afat prej një viti pas fillimit të operimit të sjell në ARH një sistem të përditësuar të SMS (Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë), të dëshmojë se kompania është duke e implementuar SMS. Nëse Railtrans dështon në përmbushjen e këtij kushti që në një afat prej një viti nga fillimi i operimit, atëherë ARH do të marrë në konsideratë revokimin e certifikatës së sigurisë (pjesa A dhe B).

Në të kaluarën ka qenë praktikë që të gjitha vendimet e departamenteve profesionale të ARH-së janë miratuar një herë nga Bordi Mbikëqyrës dhe mandej janë nënshkruar nga departamenti. Në rastin tonë ne nuk kishim Bord Mbikëqyrës qysh prej muajit Prill 2014, prandaj çështja e dhënies së certifikatës së sigurisë për kompaninë Railtrans dukej me e komplikuar. Prandaj departamenti i sigurisë ka kërkuar interpretim ligjor të zyra ligjore e ARH, zyra ligjore e Ministrisë së Infrastrukturës dhe të zyra ligjore e Kuvendit të Kosovës lidhur me procedurat se si te veprohet në mungesë të bordit mbikëqyrës të ARH-së. Duke u bazuar në tre interpretimet (opinionet) ligjore të cekura, departamenti i sigurisë bazuar në Ligjin 04/L-063, nenin 18 paragrafin 3.4 si dhe nenin 104 paragrafin 6 dhe nenin 38 paragrafin 6, departamenti i sigurisë mori vendim që me datë: 03.10.2016 të japë Certifikatën e Sigurisë për operatorin privat Railtrans, sipas kushteve të parapara në draft vendimin e datës: 09.06.2016. Kurse me datë: 04.10.2016 kemi dhënë Certifikatën e Sigurisë për kompaninë Railtrans.

*Me datë: 04.10.2016, Kemi dhënë Certifikatën e Sigurisë
pjesa A dhe B për kompaninë Railtrans*

ARH- Departamenti i Sigurisë bën lëshimin e certifikatave dhe autorizimeve të sigurisë pjesa A dhe B. Bazuar në Udhëzimin administrativ Nr. 04/2012 për dhënien e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të

sigurisë për NH dhe MI, neni 11 paragrafi 1, certifikimi dhe autorizimi i sigurisë është pa pagesë deri në futjen në fuqi të Rregullorës së ARH-së për Taksa dhe Gjoba.

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktivën 2004/49/EK

Nr. Identifikues: **KS 11 2016 0001**

1. NDËRMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi Ligjer: "Railtrans" L.L.C.	
Emri i operatorit hekurudhor: "Railtrans" L.L.C.	Shtetësi: Railtrans L.L.C.
Nr. i Bisedës: 70487616	Nr. i Tshk: 330017469

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Shteti: Republika e Kosovës

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një: ☒ -Certifikatë e re ☐ -Certifikatë e rinovuar ☐ -Certifikatë e ndryshuar

Numeri i identifikimit të Certifikatës së me parashmë:

E vlefshme nga: **04.10.2016** Deri: **03.10.2021**

Lloji i shërbimeve: Transporti i mallrave: Duke përfshirë shërbimet për mallra të rrezikshme (2.10)

Vëllimi i transportit: Më pak se 500 milion ton-km për vit (2.12)

Madësia e ndërmarrjes hekurudhore: Ndërmarrje e vogël (2.17)

4. LEGJISLACIONI NACIONAL NË FUQI

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 02/2012

5. INFORMATAT SHITESË

Operatori hekurudhor "Railtrans" L.L.C. obligohet që në afat prej 12 muaj, nga data e fillimit të operimeve të punojë dhe sjellë në ARH, Sistemin e detajuar për Menaxhimin e Sigurisë (SMS)

Data e lëshimit: **04.10.2016**

Namuri i brendshëm i referencës: **CER 01/2016**

Nenshtypur: **Altin Mehmetaj**
Vila e Autoritetit:

Nr. Bisedës Statistike: 29
Postofisi: Prishtinë
Telefoni: +383 62 22 00 40
Fax: +383 62 22 00 40
www.arh-ko.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA B

Certifikata e Sigurisë që konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara për ndërmarrjet hekurudhore me qëllim përmbledhjen e kërkesave specifike për operim të siguri në rejeta përkatës në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, udhëzimin përkatës administrativ 04/2012 dhe rregulloren 03/2012, në përputhje me Direktivën 2004/49/EK

Nr. Identifikues: **KS 12 2016 0001**

1. NDËRMARRJA E CERTIFIKUAR HEKURUDHORE

Emërtimi Ligjer: "Railtrans" L.L.C.	
Emri i operatorit hekurudhor: "Railtrans" L.L.C.	Shtetësi: "Railtrans" L.L.C.
Nr. i Bisedës: 70487616	Nr. i Tshk: 330017469

2. CERTIFIKATA E LËSHUAR NGA INSTITUCIONI

Institucioni: Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Shteti: Republika e Kosovës

3. INFORMATAT E CERTIFIKATËS

Kjo është një: ☒ -Certifikatë e re ☐ -Certifikatë e rinovuar ☐ -Certifikatë e ndryshuar

Numeri i identifikimit të Certifikatës së me parashmë:

E vlefshme nga: **04.10.2016** Deri: **03.10.2021**

Lloji i shërbimeve: Transporti i mallrave: Duke përfshirë shërbimet për mallra të rrezikshme (3.10)

4. CERTIFIKATA E SIGURISË-PJESA A (Pranimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë)

Namuri i identifikimit: **KS 11 2016 0001**

5. LINJAT E OPERIMIT

Të gjitha linjat ekzistuese në territorin e Republikës së Kosovës

6. KUMETET E VEÇANTA DHE DETYRIMET

Nuk ka

7. LEGJISLACIONI NACIONAL I APLIKUESHËM

Ligjislacioni në fuqi: Ligji Nr. 04/L-063, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 dhe Rregulloren Nr. 02/2012

Data e lëshimit: **04.10.2016**

Namuri i brendshëm i referencës: **CER 01/2016**

Nenshtypur: **Altin Mehmetaj**
Vila e Autoritetit:

Nr. Bisedës Statistike: 29
Postofisi: Prishtinë
Telefoni: +383 62 22 00 40
Fax: +383 62 22 00 40
www.arh-ko.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Fig.4.

2. Mbikëqyrja e implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) nga MI dhe NH.

Departamenti i sigurisë gjatë vitit 2016 nuk ka paraparë mbikëqyrjen e implementimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) nga MI dhe NH, pasi që këtë e kemi kryer gjatë vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016 kemi mbikëqyrur implementimin e rekomandimeve të dala nga raporti i me hershëm.

2.1. Mbikëqyrja e menaxherit të infrastrukturës hekurudhore (MI)

Qëllimi i mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Infrakos e ka vendosur Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

2.2. Mbikëqyrja e ndërmarrjes hekurudhore (NH)

Qëllimi i këtij procesi të mbikëqyrjes së implementimit të SMS ka qenë që të sigurohemi se Trainkos e ka vendosur Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe ky sistem plotëson kërkesat e sigurisë dhe përmban elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor në Kosovë.

2.3. Inspektimi i linjave hekurudhore

Gjatë vitit 2016 departamenti i sigurisë ka bërë inspektimin e infrastrukturës hekurudhore të të gjitha linjave ekzistuese funksionale dhe jo funksionale.

Linjat funksionale të inspektuara janë:

Fushë Kosovë – Prishtinë (29.04.2016)

Terminali i mallrave Miradi (05.05.2016)

Fushë Kosovë – Magure (06.05.2016)

Fushë Kosovë – Hani i Elezit (30.08.2016)

Fushë Kosovë – Pejë (21.11.2016)

Linjat jo-funksionale te inspektuara janë:

Prishtinë – Podujevë (21.09.2016)

Fushë Kosovë – Mitrovicë (23.09.2016)

Klinë – Prizren (26.09.2016)

2.3.1. Ne vazhdim po e paraqesim disa pjese te raporteve te linjave te cilat janë funksionale dhe atyre te cilat janë jashtë funksionit.

2.3.2. Linjat Funksionale



Fig.5.



Fig.6.

Në këto fotografi shihet gjendja e infrastrukturës hekurudhore ne stacionin hekurudhor te Lipjanit, siç shihet ne foto sistemi i sinjalizimit është ne gjendje funksionale shtresa e balastit e mjaftueshme, elementet përbërëse te ndërruesve jastëkët dhe dallëndyshja janë te vajosura, traversat ne gjendje te mirë teknike, ndriçimi ekziston vetëm ne objektin e stacionit kurse ne afërsi te platformës nuk ka ndriçim, platforma e stacionit e pa shenjzuar.



Fig.7.



Fig.8.

Përpos rastit të mësipërm ku gjendja është relativisht e mirë kemi edhe rastet ku gjendja nuk paraqitet e mirë. Në këto fotografi shihet vendkalimi legal i cili gjendet përafërsisht në kilometrin 277+00 në rrugën e Sarajit, vendkalimi është tërësisht i pa siguruar mungojnë shenjat e trafikut në të dy anët e rrugës, dukshmëria afër vendkalimit është e mirë.



Fig.9.



Fig.10.

Në këto fotografi është paraqitur gjendja e infrastrukturës hekurudhore në stacionin hekurudhorë të Prishtinës, siç shihet në fotografi platforma e stacionit ka filluar të dëmtohet nga shembja si dhe nuk është e shenjëzuar, traversat janë në gjendje të mirë, shtresa e balastit është e mjaftueshme, ndërrueset të cilat gjenden në stacion janë të vajosura, shenja S për ndalimin e trenit në stacion ekziston dhe ka dukshmëri të mirë, sistemi i ndriçimit në platform është jashtë funksionit.

2.3.3. Linjat jo Funksionale



Fig.11.



Fig.12.

Te linjat të cilat janë jashtë funksionit gjendja paraqitet me e renduar, siç shihet në foto gjendja ekzistuese e vendkalimit ilegal dhe sinjalit i cili gjendet ne fshatin Bardhosh. Vendkalimi është i pa siguruar mungojnë shenjat e rrezikut ne të dy anët e rrugës, ka mungese te balastit, një pjesë e traversave janë mbuluar nga balta, mirëmbajtja pranë binarëve nuk është e mirë barishtat kane filluar ti mbulojnë binaret, sinjali i cili shihet ne foto gjendet disa metra larg vendkalimit dhe është jashtë funksionit.



Fig.13.



Fig.14.

Gjithashtu edhe në këtë linjë (Klinë-Prizren) gjendja nuk është e mirë, ashtu siç edhe shihet në këto fotografi shihet gjendja e disa traversave ne hyrje te tunelit ne Gexhë si dhe gjendja e tunelit. Traversat kanë filluar të kalben, po ashtu ka mungesë te bulonave shtrëngues te cilët bëjnë lidhjen e traversave dhe binarëve, ne foton e dytë shihet gjendja e tunelit siç shihet barishtat e kane mbuluar hekurudhën, shtresa e balastit e pa mjaftueshme, disa traversa ne tunel janë te dëmtuara.

Inspektimet e linjave hekurudhore gjatë vitit 2016		Fushë Kosovë Medvec Magure	Prishtinë Fushë Kosovë	Fushë Kosovë Hani i Elezit	Fushë Kosovë Pejë	Prishtinë Podujevë	Fushë Kosovë Mitrovicë	Klinë Prizren
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	1	1	1	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	0	0	0	0	0	0	0
	Realizuara	1	1	1	1	1	1	1

Tab.14.

2.4. Inspektimi i mjeteve lëvizëse

Gjatë vitit 2016 departamenti i sigurisë ka bërë inspektimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë në menaxhim të: Infrakos, Trainkos dhe Ferronikelit.

2.4.1. Inspektimi i mjeteve lëvizëse të Infrakos

Më poshtë po i paraqesim disa nga elementet e inspektuara të një mjeti lëvizës të Infrakos-it.

Plasser&Theurer tipi 08-16-SH

Numri i autorizimit **KS/54/2014/0001**

Numri evropian **99 00 9428 008-0**

Janë inspektuar:

- Trashësia e rrotave
- Dimensionet i profilin të rrotave
- Sistemi i frenimit
- Papuçet e frenimi (disk)
- Sistemi i ndriçimit
- Pajisjet kundër zjarrit
- Karrociera e mjetit lëvizës
- Xhami i përparmë dhe anësor dhe fshesat e xhamit të përparmë etj.



Fig.15.



Fig.16.

2.4.2. Inspektimi i mjeteve lëvizëse te Trainkosit

2.4.2.1.inspektimi i vagonëve te mallrave te Trainkos-it

Lokomotivë për transport të mallrave dhe udhëtarëve

- Numri i autorizimit **KS / 51 / 2013 0012**
- Numri evropian **92 00 2620 005-4**

Janë inspektuar:

- Trashësia e rrotave
- Dimensionet i profilin të rrotave
- Sistemi i frenimit
- Papuçet e frenimi (disk)
- Sistemi i ndriçimit
- Pajisjet kundër zjarrit
- Buria dhe Radio Lidhja
- Karrocëria e mjetit lëvizës
- Lidhëset e ajrit dhe Çengeli
- Xhami i përparmë dhe anësor dhe fshesat e xhamit të përparmë etj.



Fig.17.



Fig.18.

Numri i inspektimeve të mjeteve levizese gjate vitit 2015

Inspektimi i llojeve te mjeteve levizese		Lokomotivë	Lokomotivë Manovruese	Tren motorik	Vagonë te mallrave	Vagonë te udhetarëve
Numri i Inspektimeve	Planifikuara	1	1	1	1	1
	Pa Planifikuara	0	0	0	0	0
	Realizuara	1	1	1	1	1

Tab.15.

G. BURIMET E INFORMACIONIT

Raporti vjetor i sigurisë për vitin 2016, është përgatitur bazuar në aktivitetet e departamentit të sigurisë gjatë vitit të lartë përmendur si dhe nga raportet e sigurisë të Infrakosit dhe Trainkosit dhe Ferronikelit.

Menaxheri i Infrastrukturës	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Infrakos Sh.A	28.06.2016

Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Trainkos Sh.A	29.06.2016

Ndërmarrja hekurudhore (NH)	Data e dorëzimit të raportit vjetor të sigurisë
Railtrans	21.06.2016

Inspektimet	Data e dorëzimit të raportit të inspektimit me rekomandime të sigurisë për Infrakos-in
Infrastruktura dhe mjetet lëvizëse	29.12.2016


Inspektimet	Data e dorëzimit të raportit të inspektimit me rekomandime të sigurisë për Trainkos-in
Mjetet lëvizëse	29.12.2016

Inspektimet	Data e dorëzimit të raportit të inspektimit me rekomandime të sigurisë për Ferronikelin
Vagonët e mallrave	29.12.2016


Tab.16.

ANEKSI A STRUKTURA E INFORMACIONEVE HEKURUDHORE

A.1 Harta e rrjetit hekurudhor



Tab.17.



Tab.18.



Tab.19.

A.2 Lista e menaxherëve të infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjeve hekurudhore (NH)

A.2.1 Menaxheri i Infrastrukturës

Emri	Adresa	Web faqja	Autorizimi i Sigurisë A-B (datë/numër)	Data e fillimit të aktivitetit komercial	Gjatësia e përgjithshme e linjës/gjerësia
Infrakos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.infrakos.com	24.01.2013 KS 21 2013 001 KS 22 2013 001	23.12.2005	333.451/1435

Tab.20.

A.2.2. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numër)	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Trainkos Sh.A.	Sheshi i Lirisë pn. 12000 Fushë Kosovë Republika e Kosovës	www.trainkos.com	24.01.2013 KS 11 2013 001 KS 12 2013 001	16.08.2011

Tab.21.


A.2.3. Ndërmarrja Hekurudhore

Emri	Adresa	Web faqja	Certifikata e Sigurisë A-B (datë/numër)	Data e fillimit të aktivitetit komercial
Railtrans	Ish fabrika e Amortizatorve terminali doganor Republika e Kosovës	www.railtrans.biz	04.10.2016 KS 11 2016 001 KS 12 2016 001	06.05.2008

Tab.22.


ANEKSI B - STRUKTURA ORGANIZATIVE

B.1. Grafiku: Organizimi i brendshëm i ARH-së gjatë vitit 2015 ishte si më poshtë.




Tab.23.


B.2. Grafiku: Rrjedha Organizative (marrëdhëniet) ndërmjet Autoritetit Rregullativ të hekurudhave (ARH) me organet e tjera kombëtare.



Tab.24.




Tab.25.




Tab.26.

Vendkalimet në vitin 2016




Tab.27.

Vendkalimet në vitin 2016



Tab.28.



Tab.29.

ANEKSI C.

C.1. Definicionet e zbatueshme në pajtim me ligjin 04/L-063 për hekurudhat e Kosovë dhe Rregulloren Nr 2003/91/EC

Person i vrarë

Do të thotë çdo person i vrarë menjëherë ose vdekur brenda 30 ditëve, si rezultat i një aksidenti, me përjashtim të vetëvrasjeve;

Person i plagosur rëndë

Nënkupton çdo person i plagosur i cili është shtruar në spital për më shumë se 24 orë, si pasojë e një aksidenti, duke përjashtuar tentim vetëvrasjet;

Km-Udhëtarëve

Nënkupton njësinë e masës që përfaqëson transportin e një udhëtari me hekurudhë gjatë një distancë prej një kilometri. Vetëm distanca në territorin kombëtar të raportimit Vendi do të merren parasysh;

Vetëvrasje

Nënkupton aktin me dashje të lëndojë veten duke rezultuar në vdekje, regjistruar dhe klasifikuar si i tillë nga autoriteti kompetent kombëtar;

Aksidenti

Nënkupton ngjarjen e padëshirueshme dhe të paqëllimtë apo zinxhirin specifik të ngjarjeve të tilla të cilat kanë pasoja dëmtuese;

Aksidenti serioz

Nënkupton ndonjë ndeshje apo rrëshqitje të trenave që rezulton në vdekjen e të paktën një personi apo lëndimet serioze të së paku pesë apo më shumë personave apo dëmtim të gjerë të mjeteve lëvizëse hekurudhore, infrastrukturës dhe mjedisit apo ndonjë aksident tjetër i ngjashme me ndikim të dukshëm në rregulloren e sigurisë hekurudhore apo në menaxhimin e sigurisë;

Incidenti

Nënkupton ndonjë ndodhi tjetër nga aksidenti apo aksidenti serioz që shoqërohet me operimin e trenave dhe që ka efekt në sigurinë e operimit;

Treni

Nënkupton kompozicionin e mjeteve lëvizëse hekurudhore duke përfshirë këtu edhe tërheqjen;

Vendkalimi

Nënkupton kryqëzimin e vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel.

Shkurtesat:

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ERA	European Railway Agency
SEETO	South East European Transport Observer
MI	Menaxheri i Infrastrukturës
NH	Ndërmarrja Hekurudhore
SMS	Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë
RVS	Raporti Vjetor i Sigurisë
TPS	Treguesit e Përbashkët të Sigurisë
OHA	Organi për Hetimin e Aksidenteve
RINF	Regjistri i Infrastrukturës
TSI	Technical Specifications for Interoperability
STI	Specifikat Teknike për Interoperabilitet
ORR	Office of Rail & Road
MPS	Metodat e Përbashkëta të Sigurisë
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike